

VENDIM
Nr.170, datë 10.3.2010

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.90, DATË 28.1.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PAGAT E ATASHEVE USHTARAKË, TË USHTARAKËVE TË
FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, QË SHËRBEJNË
NË PËRFAQËSINË USHTARAKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PRANË NATO-
S, NË SHTABET E NATO-S, NË ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE DHE NË
SHTABET USHTARAKE NDËRKOMBËTARE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2010”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.90, datë 28.1.2008 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto shtesa:
 - a) Në titullin e vendimit, pas fjalëve, “... të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të Republikës së Shqipërisë...”, shtohen fjalët “...dhe personelit civil të Ministrisë së Mbrojtjes...”.
 - b) Në paragrafin e parë të pikës 1, pas fjalës “...ushtarakët...”, shtohen fjalët “dhe punonjësit civilë të Ministrisë së Mbrojtjes, vetëm në rastet kur në strukturë parashikohet përfaqësimi i barasvlershëm me një ushtarak me gradë të caktuar, ...”.
 - c) Në pikën 2, pas fjalës “...ushtaraku...”, shtohen fjalët “...dhe punonjësi civil i Ministrisë së Mbrojtjes, vetëm në rastet kur në strukturë parashikohet përfaqësimi i barasvlershëm me një ushtarak me gradë të caktuar ...”.
 - ç) Në pikën 3, pas fjalëve “... nga data e mbërritjes së ushtarakut...”, shtohen fjalët “...apo punonjësit civil të Ministrisë së Mbrojtjes ...”.
 - d) Në pikën 4, pas fjalës “...Ushtaraku ...”, shtohen fjalët “...dhe punonjësi civil i Ministrisë së Mbrojtjes, vetëm në rastet kur në strukturë parashikohet përfaqësimi i barasvlershëm me një ushtarak me gradë të caktuar ...”.
 - dh) Në pikën 7, pas fjalëve “...Pagesat për ushtarakët...”, shtohen fjalët “...si dhe për punonjësit civilë të Ministrisë së Mbrojtjes, ...”.
 2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2010, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.
 3. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha